LIGJ
Nr. 9649, datë 27.11.2006

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË INSIG SHA-SË

(Ndryshuar me ligjin nr. 9892, datë 20.3.2008)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i formës dhe i formulës së transferimit të aksioneve, që zotëron shteti shqiptar në shoqërinë tregtare INSIG sha dhe i të drejtave të lidhura me to.

Neni 2
Forma e privatizimit

Forma e transferimit të 61 për qind të aksioneve të shoqërisë tregtare INSIG sha, të cilat zotërohen nga shteti shqiptar, është transferimi me anë të shitjes, në favor të investitorëve strategjikë, nëpërmjet procedurës "Tender i hapur ndërkombëtar", sipas formulës së parashikuar në nenin 3 të këtij ligji.

"Investitor strategjik" është shoqëria e huaj e sigurimeve, e njohur në tregun ndërkombëtar të sigurimeve, jorezidente në territorin e Republikës së Shqipërisë, e cila nuk është themeluar sipas ligjit shqiptar, por ka qenë e suksesshme në treg dhe është në gjendje të demonstrojë e të përmbushë kapacitetet e kërkuara për zhvillimin e INSIG-ut, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Neni 3
Formula e privatizimit

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 9892, datë 20.3.2008)

Për 39 për qind të aksioneve të INSIG-ut, që u janë transferuar BERZH-it dhe IFC-së, nëpërmjet shitjes, zbatohen dispozitat e ligjit që ka miratuar marrëveshjen e transferimit të këtyre aksioneve, si dhe të ligjit që përcakton të drejtat për rishitje.

Struktura e formulës së privatizimit të INSIG sha-së është si më poshtë:

1. 61 për qind e aksioneve u ofrohen për shitje investitorëve strategjikë, të cilët përzgjidhen në bazë të procedurave të përcaktuara nga Ministria e Financave, me tender të hapur ndërkombëtar, brenda datës 31 dhjetor 2008.

2. Nëse aksionerët e tjerë të INSIG sha-së vendosin të transferojnë të drejtën e pronësisë së aksioneve të tyre tek i njëjti investitor strategjik, i përzgjedhur me procedurat e zhvilluara nga Ministria e Financave, për transferimin e të drejtave të lidhura me aksionet e zotëruara prej tyre, zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 4
Vlerësimi i çmimit dhe përzgjedhja e vlerësuesit

Vlera e të drejtave të lidhura me aksionet, me të cilën do të fillojnë negociatat për shitjen e tyre, bëhet nga një vlerësues ndërkombëtar i njohur në këtë fushë. Kjo vlerë miratohet nga Këshilli i Ministrave, i cili miraton edhe kriteret e veçanta dhe marrëveshjen për transferimin e të drejtave të lidhura me aksionet e zotëruara nga shteti shqiptar në shoqërinë INSIG sha.

Përzgjedhja e vlerësuesit ndërkombëtar bëhet me tender të hapur ndërkombëtar, ndërsa në rastin e shitjes edhe të aksioneve të zotëruara nga BERZH-i dhe IFC-ja, përzgjedhja bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.

Neni 5
Monedha e pagesës

Transferimi i aksioneve në favor të investitorëve të përzgjedhur sipas këtij ligji bëhet në një monedhë të huaj, sipas përcaktimit të bërë nga Ministri i Financave.

Neni 6
Aksionet e mbetura

Kur pas përzgjedhjes dhe transferimit, sipas këtij ligji, të aksioneve në favor të investitorëve strategjikë do të kenë mbetur aksione të pashitura, ato u shiten me ofertë publike subjekteve private shqiptare brenda tre vjetëve nga data e transferimit të aksioneve në favor të investitorëve strategjikë. Pagesa për shitjen e aksioneve subjekteve private shqiptare bëhet në monedhën vendase.

Neni 7
Detyrimet e investitorëve

Investitorët, pjesëmarrës në procesin e shitjes së aksioneve të zotëruara nga shteti shqiptar në INSIG sha, duhet të respektojnë kërkesat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe, në mënyrë të veçantë, kërkesat e parashikuara nga legjislacioni tregtar dhe ai i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë.

Investitorët e përzgjedhur sipas këtij ligji, për zotërimin e aksioneve të shoqërisë INSIG sha, duhet të bien dakord, paraprakisht, për të miratuar çdo ndryshim të nevojshëm në statutin e INSIG sha-së, për nënshkrimin e aksioneve të shoqërisë nga aksionerët e rinj, siç parashikohet në këtë ligj dhe të mbrojnë të drejtat e aksionerëve në minorancë të shoqërisë, sipas standardeve bashkëkohore të drejtimit të përbashkët.

Neni 8
Zbatimi i privatizimit

Ministria e Financave, në bashkëpunim me BERZH-in dhe IFC-në, të cilave u janë transferuar 39 për qind të aksioneve, kryen procedurat e privatizimit të INSIG sha-së, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 9
Nxjerrja e akteve

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 10
Zgjidhja e investimeve

Ngarkohet Ministria e Financave që, përpara procesit të transferimit të aksioneve të zotëruara nga shteti shqiptar në INSIG sha, të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave aktet e nevojshme nënligjore për zgjidhjen e problemeve të investimeve të kryera nga INSIG sha, për rritjen e vlerës së shitjes së këtyre aksioneve.

Neni 11
Shfuqizime

Ligji nr.8899, datë 22.5.2002 "Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG sha-së", shfuqizohet.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5153, datë 12.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu